




Pranimi / Dorezimi Prilazimi / Prilazje Receipt / Delivery	03 - 11 - 2020	vit and year
Organ / Njesia Org. Unit	No. Prot. Pr. Prot. No.	Shtesa Prilazje Appendix
SKPMSTLK	2427 / 2020	Sasia Kolicina Quantity
		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A .nr. 279/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me zyrtaren e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër protokoll 1863/2020 të datës 22.09.2020, të parashtruar nga ankuesja [REDACTED] me banim në Rr. “Zekerija Cana”nr.56 Gjilan, në çështjen juridike “kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa me numër protokoll 1863/2020 e datës 22.09.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.24/2020 i datës 07.08.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan, me datën 24.06.2020 ka parashtruar kërkesën për pagën jubilarë në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e cila kërkesë ju ka refuzuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me vendimin DS-392/2020 të datës 25.06.2020, me arsyetimin se ankuesja e ka marrë pagën jubilarë në vitin 2012.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin DS-392/2020 të datës 25.06.2020 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 17.07.2020 ka parashtruar ankesën me nr.09/657 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Vendimin KA.nr.24/2020 të datës 07.08.2020 me nr. protokoll 714, ka refuzuar ankesën e ankueses si te

pabazuar. Ankuesja e pakënaqur me vendimin KA.nr.24/2020 të datës 07.08.2020 me nr. protokollin 714 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 22.09.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollin 1863/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Më datë 20.10.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes e-mailit bashkë me provat e lëndës faqe 1/12.

Administrimi i Provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 1863/2020 e datës 22.09.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 24.06.2020 e parashtruar në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi DS-392/2020 i datës 25.06.2020, Ankesa e datës 14.07.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me nr.KA.nr.24/2020 të datës 07.08.2020 me nr. Protokollin 714; Libri amëz i punëtorëve; Shkresë emërimi i datës 01.03.2001; Shkresë emërimi i datës 23.12.2002; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 15.12.2005; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 23.12.2005; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 20.03.2006; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 19.06.2006; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 27.09.2006; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 27.12.2006; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 13.06.2007; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 11.12.2007; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 11.12.2008; Akt emërimi i datës 05.01.2012; Akt emërimi i datës 01.01.2013; E-mail i datës 27.10.2020; E-mail i datës 28.10.2020; E-mail i datës 03.11.2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 20.10.2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/12.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që të bëhet pagesa e paës jubilarë prej vitit 2000 e që ende është duke ushtruar pozitën e Sekretares Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesja është nëpunëse civile në Gjykatën Themelore në Gjilan, pagën jubilarë e ka marrë në vitin 2012 për 10 vite përvojë pune në Shërbimin Civil të Kosovës që do të thotë se ankuesja ende nuk i plotëson kushtet për pagën e dytë jubilarë, andaj pretendimi ankimor i ankueses se i takon edhe një pagë jubilarë në vitin 2020 pasi që punën në Gjykatën Themelore në Gjilan e ka filluar në vitin 2000 është i paqëndrueshëm sepse Shërbimi Civil i Kosovës fillimisht është krijuar me Rregulloren 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës e cila rregullore ka hy në fuqi më 22 dhjetor të vitit 2001, andaj rrjedhimisht edhe të drejtat dhe detyrat që lindin nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, e që të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore janë nxjerrë pas hyrjes në fuqi të Rregullores 2001/36 e UNMIK-ut.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Vendimin KA.nr.24/2020 të datës 07.08.2020 me nr. protokollin 714, me të cilin është refuzuar ankesa e ankueses, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore

në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuseses, ██████████
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A.nr. 279/2020;

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

